

**MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË MINISTRINË E MIRËQËNIES SOCIALE,  
RINISË DHE SPORTEVE**

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Ministrinë e Mirëqenies Sociale, Rinisë dhe Sporteve, për projektin SAMP “Modernizimi i Asistencës sociale”, me objekt “Mbi zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare” për periudhën nga 01.01.2013 deri 31.12.2013, dhe masat për përmirësimin e gjendjes janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 147 datë 10.10.2014.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23/12/1997 “Për kontrollin e Lartë të Shtetit”, ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 1/6/2000, me shkresën nr. 583/8 datë 10.10.2014, dërguar Z. Erjon Veliaj, Ministër i MMRS, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

**A. MASA ORGANIZATIVE**

**I. Për Njësinë e Zbatimit të Projektit.**

**I.1.** Nga auditimi i kryer u konstatua se, niveli i disbursimeve ka qenë me ritme të ulëta, për arsye se nga fondet e akorduara nga huaja në shumën prej 38 milionë Euro, janë financuar në shumën 1,140,700 Euro, ose në masën 3 % të shumës së huas për dy pjesët e projektit. Përkatësisht:

- Në vitin e parë të projektit, është realizuar vetëm një aktivitet nga 17 aktivitete të përcaktuara sipas marrëveshjes së huas, ndërsa për pjesën e dytë të projektit janë zhvilluar 8 procedura prokurimesh nga 17 procedura të miratuara nga BB dhe Ministria, për arsye se disbursimet nga banka janë mbi bazë të plotësimit të rezultateve dhe plotësimit të indikatorëve të realizimit të disbursimeve (DLI).

- Për vitin 2013, niveli i disbursimeve nga huaja ka qenë i ulët për arsye se nga 17 indikatorë gjithsej për pjesën e parë të projektit “Forcimi i zbatimit dhe performancës së programeve të asistencës sociale”, është realizuar vetëm indikator i parë “Të paktën 90% e administratorëve socialë në tri rajonet pilote, Tiranë, Durrës, Elbasan, janë trajnuar rreth zbatimit të formulës së unifikuar të pikëzimit për programin e ndihmës ekonomike”, në shumën 1,045,000 euro ose në masën 2.75% të shumës së huas, ndërsa pjesa e dytë e projektit “Asistenca teknike për forcimin e kapacitetit zbatues për programet e ndihmës sociale”, është realizuar në shumën 95,700 Euro ose në masën 0.25% të huas.

***Për këtë rekomandojmë:***

- 1. Të rritet angazhimi nga institucionet implementuese dhe të merren masa për të realizuar dhe plotësuar indikatorët vijues të pjesës së parë të projektit, duke synuar rritjen e nivelit të disbursimeve nga fondet e Bankës Botërore.***

2. *Të monitorohet në vijimësi ecuria e zbatimit dhe përmbushjes së detyrimeve që rrjedhin nga Marrëveshja e Huasë, Manuali Operacional dhe Planet e Veprimit të miratuara, brenda afateve dhe sipas pritshmërive.*

*Menjëherë dhe në vazhdimësi*

I.2.- Nga auditimi i kryer konstatohet se, Fondet e akorduara nga kredia e IBRD, nuk janë audituar nga auditues të pavarur të pranueshëm për Bankën.

*Për këtë rekomandojmë:*

3. *Nga Banka Botërore në bashkëpunim me Ministrinë e Financave të marren masa për fillimin në kohë të përshtatshme të procedurave për kontraktimin dhe kryerjen e auditimit nga audituesit e pavarur të Pasqyrave Financiare të Projektit në mënyrë që të sigurohet përmbushja e detyrimit brenda afateve dhe kërkesave të përcaktuara në Marrëveshjen e Huasë. Auditimi i pasqyrave financiare që lidhen me projektin, kryhet për çdo vit kalendarik duke filluar nga viti i parë i zbatimit të tij dhe Raportet e Auditimit, duhet të dorëzohen tek Banka Botërore jo më vonë se 6 muaj pas përfundimit të kësaj periudhe, në përputhje me Marrëveshjen e Huasë, Programi 2, Seksioni II, pika B. 3.*
4. *Ndërsa për auditimin e Komponentit nr. 1, Programi i Ndihmës Ekonomike, Banka Botërore dhe KLSH, të vendosë marrëveshje angazhimi për të planifikuar dhe realizuar auditimin e përvitshëm të pasqyrave financiare të projektit, sipas kuadrit të raportimit financiar në Shqipëri dhe në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të SAI-ve, si dhe termave të referencës të pranueshme nga palët e interesuara, brenda afateve dhe kushteve të caktuara në Marrëveshjen e Kredisë.*

*Në vazhdimësi*

## **II. Lidhur me auditimin e Raporteve Financiare Vjetore për periudhën 1 Janar – 31 Dhjetor 2013.**

Nga auditimi i informacionit financiar të deklaruar në Raportin Vjetor Financiar të Projektit për Komponentin nr. 1, të Projektit “Modernizimi i Asistencës Sociale” të Programit të Ndihmës Ekonomike si dhe transaksioneve të kryera nëpërmjet Degëve të Thesarit në Rrethe dhe Njësie të Qeverisjes Lokale u konstatua sa më poshtë:

II.1. Në disa rrethe ka nivel të ulët ose mungon komunikimi midis palëve të interesuara (aktorëve) në ekzekutimin e Programit të Ndihmës Ekonomike, ç’ka në shumicën e rasteve ka ardhur si pasojë e implikimeve të pikëpamjeve politike dhe niveleve të ndryshme të qeverisjes që janë të përfshira në Program. Pasojat e mos komunikimit korrekt në kohë dhe me përgjegjshmëri kanë sjelle në jo pak raste vështirësi në marrjen e vendimeve të mirinformuara dhe në kohë, element ky që i *mungon praktikave të qeverisjes së mirë*. Kjo situatë konsiderohet që në të ardhmen të mbartë **rrezikun e mosarritjes së objektivave të Programit;**

*Për këtë rekomandojmë:*

5. *Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Shërbimi Social Shtetëror dhe përfaqësuesit e njësive të qeverisjes vendore me mbështetjen e Bankës Botërore të hartojnë Marrëveshje të Bashkëpunimit nën kuadrin e implementimit të Programit Ndihma Ekonomike, lidhur me dhënien dhe shkëmbimin e informacionit, llojin e informacionit, shtrirjen dhe kohën e sigurimit të këtij informacioni, si dhe personat përgjegjës për kryerjen e veprimtarive të përfshira në këtë Program .*

*Mënjëherë*

II.2. Nga auditimi i kryer konstatohet se, kushtet dhe kriteret e përcaktuara për përfitim në kuadrin e Programit të Ndhmës Ekonomike, shpesh konsiderohen të papërshtatshme financiarisht për atë shtresë të popullsisë që është subjekt i përfitimit nga Programi i Ndhmës Ekonomike duke krijuar mundësinë e *devijimit nga synimet dhe fokusi i Programit*. Vështirësitë për sigurimin e dokumentacionit të kërkuar, mbartin shpenzime të cilat janë të papërballueshme për këtë shtresë të popullsisë, dhe si rrjedhojë **përfshijnë nga shërbimi popullsinë në nevoja konkrete për këtë mbështetje.**

*Për këtë rekomandojmë:*

6. *Ministria Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Shërbimi Social Shtetëror dhe njësitë e qeverisjes vendore në bashkëpunim, të ndërmarrin iniciativa për ndryshimin dhe përshtatjen e kuadrit përkatës ligjor e procedural, për të siguruar në mënyrë efektive informacionin e nevojshëm në rrugë zyrtare nga Institucionet përkatëse, zotëruese të informacionit, sikurse është Zyra e Regjistrimit të Pasurive, agjencitë shtetërore e publike dhe organizma të tjera. Krahas sa më sipër këto ndryshime duhet të synojnë rregullimin e çështjeve të tjera që shoqërojnë këto procese siç janë kostot që do të kryhen dhe cila prej palëve do t'i përballojë ato.*

*Menjëherë në vazhdimësi*

II.3. Nga auditimi i kryer konstatohet se, në raste të veçanta, administrimi i dosjeve paraqet *mangësi të informacionit (jo materiale)*. Sistemi i organizimit dhe administrimit të dosjeve duhet të sigurojë ofrimin e informacionit të saktë dhe të sigurt që mbështet vendimet e Këshillit të njësisë së qeverisjes vendore ( bashki apo komunë) lidhur me përcaktimin e drejtë të familjeve që përfitojnë nga ky komponent.

*Për këtë rekomandojmë:*

7. *Të identifikohen mundësitë që nëpërmjet aktiviteteve të parashikuara në Projektin SAMP “Modernizimi i Asistencës Teknike”, të mbështeten dhe organizohen trajnime të përbashkëta për stafin e angazhuar në implementimin e Programit Ndihma Ekonomike, që i përket Shërbimit Social Shtetëror ashtu dhe Njësive të Qeverisjes Vendore.*

8. *Të synohet që veprimtaritë trajnuese të fokusohen në ndërtimin e kapaciteteve dhe zhvillimin e aftësive profesionale të stafit nëpërmjet trajnimeve të vazhdueshme për administratorët social dhe punonjësit lokalë. Kjo duhet të shtrihet dhe me forcimin e strukturave inspektuese që janë ngritur dhe funksionojnë pranë Shërbimit Social Shtetëror dhe Auditimin e Brendshëm në këtë Institucion.*

*Në vazhdimësi*

II.4. Nga auditimi i kryer u konstatua se, fondet e akorduara nga Ministria e Financave në Degët e Thesarit në rrethe nuk janë të detajuara për çdo nën program në veçanti, pra jepen në një zë ( 606) “ Transferta popullsisë dhe individëve” duke përfshirë kështu si fondet për Programin e Ndhmës Ekonomike ashtu dhe Paaftësisë. Kjo mënyrë e administrimit **veshtirëson menaxhimin financiar në nivel të njësisive të qeverisjes vendore duke bërë të pamundur rakordimin e informacionit lidhur me fondet e akorduara dhe ekzekutimin e tyre të detajuara sipas nën-programeve.** Si pasojë ka raste që për nevoja të ndihmës ekonomike janë përdorur fonde të akorduara për paaftësinë e përkohshme;

*Për këtë rekomandojmë:*

9. *Me qëllim mirëmenaxhimin e fondeve dhe përdorimin e tyre sipas qëllimit për të cilin janë akorduar, Ministria e Financave në bashkëpunim me Shërbimin Social Shtetëror të vendosin mekanizma të shkëmbimit të informacionit të detajuar në nivel të qeverisjes vendore. Kjo do të kërkojë që çelja e fondeve të behët e detajuar për çdo nën program në mënyrë të veçantë , nën-programi “Ndhma Ekonomike” dhe nën-programi “Pagesa për paaftësinë” me vete, dhe të dërgohet e detajuar në degët e thesarit në rrethe dhe njëkohësisht në njësitë e qeverisjes vendore.*

*Në vazhdimësi*

*Shënim: Auditimi i krye nga audituesit Albana Gjinopulli, Luljeta Shtylla, Ina Sokoli, Edmond Koçi, Nefail Xhepexhiu, Selman Hysi më tej u shqyrtua nga k/auditues Mimoza Lloji, Drejtori i Departamentit Xhaferr Xhoxhaj, Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Kontrollit të Cilësisë Ermal Yzeiraj, si dhe u verifikua si praktike nga Drejtori i Përgjithshëm Helga Vukaj.*

**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**